



Bazuar në nenin 35 paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.03/L-209 Për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.77/16 gusht 2010), bazuar dhe në zbatim të nenit 42 dhe nenit 32 Ligjit nr. 04/L-018 Për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ nr. 4/14 korrik 2011), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 korrik 2012, miratoi:

## **RREGULLORE**

### **PËR FONDIN E KOMPENSIMIT TË BYROJË KOSOVARE TË SIGURIMEVE**

#### **Neni 1**

##### **Objekti**

Kjo rregullore përcakton mënyrën e financimit, mbajtjes dhe përdorimit të Fondit të Kompensimit që administrohet nga Byroja Kosovare e Sigurimit.

#### **Neni 2**

##### **Përkufizimet**

Termat e përdorur në këtë rregullore kanë kuptim të njëjtë siç përcaktohen në Ligjin nr. 04/L-018 Për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia.

#### **Neni 3**

##### **Qëllimi**

Fondi i Kompensimit ka për qëllim pagesën e dëmeve në territorin e Republikës së Kosovës, sipas dispozitave të neneve 18, 19, 20, 21, dhe 22 të Ligjit nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia dhe nuk mund të përdoret për qëlime tjera.

#### **Neni 4**

##### **Financimi**

1. Fondi i Kompensimit financohet nga:

1.1 Kontributet e rregullta të siguruesve të licencuar për ushtrimin e veprimtarisë së Sigurimit të Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia. Siguruesit do të kontribuojnë financiarisht në Fondin e Kompensimit në baza 3 mujore, në përpjestim të drejtë me primet e realizuara nga shitja e sigurimit të autopërgjegjësive për 3 muajt paraardhës;

1.2 arkëtimet prej rimbursimit në procedurat e regresit;

1.3 kontributet shtesë të siguruesve, kur fondi i parashikuar rezulton të jetë i pamjaftueshëm për të kryer pagesat sipas paragrafit 1 të këtij neni;

1.4 rimbursimet nga pronarët e mjeteve motorike të pasiguruara për të cilët Fondi i Kompensimit ka paguar dëmshpërblim;

1.5 të ardhurat nga investimi i mjeteve të Fondit të Kompensimit;

1.6 burimet e tjera, të cilat nuk ndalohen me ligj.

2. BKS-ja do ta informoj dhe raportoj BQK-në për shumën e kontributeve dhe përmbushjen e detyrimeve ndaj Fondit të Kompensimit nga çdo sigurues.

## **Neni 5**

### **Llogaritja e fondit të kompensimit nga Byroja**

1. Byroja cakton rezervën e Fondit të Kompensimit sipas këtyre dy komponentëve:

1.1. Sipas rezervës për dëme të ndodhura në vitet paraprake që me ligj mbulohen nga Fondi i Kompensimit dhe sipas rezervës së dëmeve të ndodhura e të raportuara (IBNR).

1.2. Kontributi që i takon vitit aktual duhet të jetë në masë të tillë që duhet të përballoj mbulimin e dëmeve që priten të ndodhin gjatë vitit aktual.

1.3. Përlllogaritja e komponentëve nga pika 1 dhe 2 si më lartë bëhet nga aktuarët e certifikuar, sipas metodologjisë aktuaristike të përcaktuar nga BQK-ja.

2. Byroja e informon BQK-në lidhur me rezervën e llogaritur sipas paragrafit 1 të këtij neni.

3. Byroja i informon siguruesit lidhur me rezervën nga paragrafi 1 këtij neni dhe i udhëzon mbi depozitimin e mjeteve në llogaritë e fondit të kompensimit.

## **Neni 6**

### **Financimi shtesë**

Me propozim të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve të Byrosë dhe pas miratimit të BQK-së, siguruesit duhet të bëjnë financim shtesë të Fondit të Kompensimit në rastet kur ky fond rezulton të jetë i pamjaftueshëm për të kryer pagesat. Shtesa e Fondit të Kompensimit llogaritet në të njëjtin raport siç përcaktohet në nenin 4.1.1.

## **Neni 7**

### **Mbajtja e llogariseë së Fondit të Kompensimit**

1. Me aprovimin e BQK-së, Byroja do të hapë llogari të veqanta në emer të Fondit të Kompensimit në minimum 3 banka komerciale të licënuara nga BQK-ja. Depozitimi në një bankë komerciale të vetme nuk mund të jetë më shumë se 35 % e totalit të Fondit të Kompensimit.
2. Mjetet e Fondit të Kompensimit mund të investohen sipas përcaktimeve të nenit 32 paragrafi 7 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, vetëm pas aprovimit paraprak nga BQK-ja.
3. Çdo Sigurues brenda datës 20 në çdo fillim të 3 mujorit, duhet të depozitoj në llogarinë e Fondit të Kompensimit shumën sipas përcaktimit të nenit 4.1.1 të kësaj rregullore.
4. Pagesat nga llogaritë e Fondit të Kompensimit mund të bëhen vetëm nga ana e personave të autorizuar të Byrosë.

## **Neni 8**

### **Rezerva për Fondin e Kompensimit nga siguruesit**

Siguruesit, në fillim të çdo viti duhet të ndajnë një rezervë dhe të pasqyrojnë atë në bilancin e gjendjes si rezervë për Fondin e Kompensimit. Llogaritja e kësaj rezerve duhet të bëhet sipas metodologjisë aktuaristike të përcaktuar nga BQK-ja.

## **Neni 9**

### **Trajtimi dhe pagesa e dëmeve nga Fondi i Kompensimit**

Trajtimi dhe pagesa e dëmeve nga fondi i kompensimit bëhet në pajtim me Ligjin për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia dhe rregulloren e BQK-së “Mbi Procedurat e Trajtimit të Kërkesave për Dëmshpërblim nga Sigurimi i Autopërgjegjësisë”.

**Neni 10**  
**Përfundimi i vitit financiar të Fondit të Kompensimit**

1. Në fund të çdo periudhe financiare (31 dhjetor) hartohet bilanci i gjendjes së Fondit të Kompensimit dhe pasqyra e kontributeve dhe pagesave të tij.
2. Në fund të çdo viti financiar (gjendja financiare si më 31 dhjetor) Fondi i Kompensimit duhet të mbyllet teorikisht. Tepricat në llogaritë e Fondit të Kompensimit me datë 31dhjetor të çdo viti, do të pasqyrohen në bilancin e Byrosë si detyrime financiare ndaj siguruesve në raport me përqindjet që ato kanë kontribuar në Fondin e Kompensimit për vitin financiar në fjalë. Në fillim të vitit financiar pasues Byroja do ti njoh në bilanc këto detyrime si pjesë të kontributit të siguruesve në Fondin e Kompensimit për këtë vit e llogaritur kjo në raport me përqindjen e kontributit që i përket çdo siguruesi për vitin aktual financiar.

**Neni 11**  
**Masat Ndëshkimore**

1. Në rast se siguruesit nuk zbatojnë detyrimet e parashikuara në këtë Rregullore, Byroja njofton BQK-në për mos zbatimin e detyrimeve, dhe BQK do të shqiptoj masa ndëshkuese të parashikuara me nenin 37 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia.
2. Në rast se Byroja nuk i zbaton dispozitat e kësaj rregullorje, BQK-ja do të shqiptoj masa ndëshkuese sipas përcaktimeve të nenit 38 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia.

**Neni 12**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 1 gusht 2012.

Gazmend Luboteni  
Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore